



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT

KORÇË

VENDIM

Nr 42 Datë 19.07.07

PËR

MIRATIM FONDI PËR TRANSPORTIN E PAJISJEVE DHE
ORENDIVE SHKOLLORE NGA DORCAS AID
INTERNATIONAL ALBANIA

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, për " MIRATIM FONDI PËR TRANSPORTIN E PAJISJEVE DHE ORENDIVE SHKOLLORE NGA DORCAS AID INTERNATIONAL ALBANIA", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh". Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007". Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 437.500 lekë për transportin e pajisjeve shkollore të grumbulluara nga Dorcas Aid International Albania, nga Holanda në Shqipëri, në qytetin e Korçës.

2. Ky fond do të përballohet nga fondi i kursyer i tenderit « Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007 » (nga fondi i N.SH.P.) me këtë strukturë buxhetore :

Pakësohet	00.	06260	05	Art. 6022008	- 437.500 lekë
-----------	-----	-------	----	--------------	----------------

Shtohet	00.	01110	05	Art. 6023900	+ 437.500 lekë
---------	-----	-------	----	--------------	----------------

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës. Drejtoria Juridike në Bashki dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE